



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1060/2 Prot.

Tiranë, më 23.10.2023

**V E N D I M**

**Nr. 209, Datë 23.10.2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 200, datë 02.10.2023, e paraqitur nga Shoqata “Ilinden”, me përfaqësues z. N. Gj, kundër shtetasit bullgar V. S, përfaqësues i Fondacionit Bullgar në Shqipëri, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues pretendon se: “Shtetasi bullgar V. S, përfaqësues i Fondacionit Bullgar, kërcënon hapur pakicën kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë. Në kohën kur po zhvillohet rregjistrimi i popullësisë, kudo ku ka popullsi maqedonase në të gjithë Republikën e Shqipërisë shkon dhe i bën presion, shkakton ankth të populli maqedonas në RSH. Në këto kushte, kërkon të meren masa për këtë shtetas”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe Komisioneri të marrë masa me gjobë dhe të heqë artikullin nga rrjeti social Facebook.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji. Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga subjekti ankues informacion dhe dokumentacion plotësues.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 03.10.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të paraqesë informacionin dhe dokumentacionin duke sqaruar si më poshtë:
  - Provat e pretenduara që na janë vënë në dispozicion janë në gjuhë të huaj, në këto kushte këto materiale duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe çdo dokument tjetër provë duhet të jetë në gjuhën shqipe, sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
  - Informacion në lidhje me linkun e saktë ku pretendohet se është publikuar artikulli objekt ankese, pasi linku i përmendur në ankesë:  
(<https://www.facebook.com/profile.php?id=100080360561260>), nga verifikimet e bëra, hap vetëm faqen e profilit të shtetasit V. S, dhe jo artikullin. (Nga një verifikim paraprak nuk u identifikuar materiali i pretenduar)
  - Informacionin e plotë për adresën e saktë të shtetasit V. S/Fondacionit Bullgar si dhe çdo informacion tjetër për identifikimin dhe mundësimin e kontaktit me këtë subjekt.

Sa më sipër, sikurse dhe pas kalimit të aftit ligjor të përcaktuar për plotësimin e kërkesave, rezultoi që subjekti ankues nuk dërgoi asnjë dokumentacion lidhur me ankesën dhe nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... ç) ..... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga Fondacioni “Ilinden”, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**